



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:131915

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05616530

P.nr.287/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit H. H. nga fsh. S. K. L., të cilin e mbronë Kimete Sahiti av. nga Lipjani sipas autorizimit, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.2387/22 të dt.09.06.2022, për shkak të veprës penale Shpërdorim i pasuris së huaj nga neni 318 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 02.04.2024, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Jakupi, të pandehurit dhe mbrojtëses se tij Kimete Sahiti av. nga Lipjani dhe në munges të dëmtuarit L. P. nga fsh. S., ndërsa me dt.04.04.2024 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

H. H., i lindur me ... në F., me vendbanim në rrugën "A. G." nr.... në fshatin S. K. L., nga babai H. dhe nëna F., e gjinisë B., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor fizik, me numër personal ..., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datën 03.05.2022, rreth orës 13:30, në fshatin S. në L., përkatësisht në kafiterinë Q., i pandehuri H. H., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ia kërkon të dëmtuarit L. P. telefonin kinse për të biseduar urgjent me një shokë dhe pasi i dëmtuari ia jap telefonin e tij iPhone 12 Pro Max, i pandehuri largohet nga kafiteria duke e përvetësuar pasurinë/telefonin i cili i është besuar atij, me ç`rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerën prej 900 euro -,

- Me këtë ka kryer veprën penale Shpërdorim i pasuris së huaj nga neni 318 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 318 par. 1 të KPRK-së, si dhe neni 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen veprën tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 200.00-€ (dyqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së do të zëvendësohet me dënim me burgim, për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€.

I dëmtuari: L. P. nga fsh. S. K. L., udhëzohen që kërkesën pasuroro juridike ta realizojnë në procedurë të rregullt civile.

DETYROHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumën prej 20-€, si dhe shumën nga 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.2387/22 të dt.09.06.2022, e ka akuzuar të pandehurin H. H. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit pasi pranimi i fajsisë është bërë konform dispozitave ligjore me vullnetin pa presion dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj dhe të pandehurin pastaj ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim sipas ligjit.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se i vjen keq ajo që ka ndodhur sepse të dëmtuarin e ka pasur shokë të shkollës fillore 9 vite me një bankë, ndien keqardhje edhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla, është punëtor fizik që siguron mbajtjen e familjes punëtor krahu dhe e ka lutur gjykatën që të ketë parasysh këto rrethana dhe ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësja e të pandehurit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se në konsultim paraprak me të mbrojturin e tij dhe pa presion, e me vullnetin e pranimit të fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe pasi ia ka shpjeguar benifitet e pranimit të fajsisë si dhe pasojat e njëjti dëshiron ta mbyll procedurën me pranimin e fajsisë andaj i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh rrethanat lehtësuese dhe ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, ky pranimi i fajsisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimit të mjaftshëm me mbrojtësen e tij, pranimi i fajtit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është i moshës së re që lenë për të kuptuar se në të ardhme mund të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla dhe se me

të dëmtuarin janë pajtuar dhe kanë raporte të mira, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin, pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma prej 20-€ u caktua në emër të paushallit gjyqësor në bazë të ndërlikshmërisë së rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për Kompenzimin e Viktimave të Krimit u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, dhe gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që në këtë procedurë nuk është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.287/22 dt.04.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Gentiana Dakaj

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.